



Zyra e Kryetarit

Datë: 30.04.2025

Kamenicë

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 35 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenin 18 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtoreve dhe Zëvendësdrejtoreve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, sipas propozimit nga Drejtoria për Arsim, neni 70 Statuti Nr. 01/20203, i datës 21.06.2023, të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

1. Nëpunësi z. Dalibor Jovanović, caktohet ushtrues detyre i Drejtorit të Shkollës së Mesme të "Radnika Teknicka Skole" Kamenicë, nga data 01.05.2025 deri me datë 31.08.2025.
2. Kompensimi do të bëhet sipas koeficientit 6.8 (klasa E13 sipas Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik).
3. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afatin prej 30 ditësh prej ditës së pranimit të vendimit pranë Komisionit të Ankesave në kuadër të Komunës së Kamenicës.

Vendimi t'i dërgohet:
Zyrës së Kryetarit;
Zyrës së Personelit (NjMBNj);
Drejtorisë për Arsim;
Z. Dalibor Jovanović;
SHM "Radnika Teknicka Skole" Kamenicë;
Arkivit.

Kadri RAHIMAJ
Kryetar i Komunës së Kamenicës